

VENDIM
Nr.793, datë 16.11.2011

**PËR DHËNIE FONDI FINANCIAR SHITESË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS,
PËR RIKONSTRUKSIONIN E PALLATIT NR.10, LAGJJA NR.6, RRUGA “M. SHKODRANI”,
KORÇË, DJEGUR NGA ZJARRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Korçë, të qarkut të Korçës, në buxhetin e vitit 2011, t’i jepet fondi financiar shtesë 4 905 000 (katër milionë e nëntëqind e pesë mijë) lekë, për rikonstruksionin e pallatit nr.10, lagjja nr.6, rruga “M. Shkodrani”, Korçë, djegur nga zjarri.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, bashkia Korçë, si dhe prefekti i qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha